

MEKTRIN MOTORS SH.P.K.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE :

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-28

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	1 janar 2018
AKTIVE				
Aktivët afatgjatë				
Aktivët afatgjatë materiale	6	974,979,814	869,927,179	714,917,330
Paradhënie për asete		-	-	8,561,605
Totali i aktiveve afatgjatë		974,979,814	869,927,179	723,478,935
Aktivët afatshkurtra				
Inventarë	7	550,609,949	687,622,631	796,075,711
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	345,815,732	225,738,786	199,120,812
Llogari të arkëtueshme të tjera	9	8,152,769	11,442,181	16,634,096
Tatim fitimi	10	8,727,671	2,519,823	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	77,326,436	35,497,341	88,815,407
Totali i aktiveve afatshkurtra		990,632,557	962,820,762	1,100,646,026
Totali i aktiveve		1,965,612,371	1,832,747,941	1,824,124,961
KAPITALI				
Kapitali aksionar/themeltar		592,834,000	592,834,000	592,834,000
Rezerva të tjera		38,548,566	240,920,506	38,548,566
Rezerva ligjore		30,209,026	14,402,526	3,751,373
Fitimi i ushtrimit		128,090,970	158,064,998	213,023,093
Totali i kapitalit	12	789,682,562	1,006,222,030	848,157,032
DETYRIMET				
Detyrime afatgjatë				
Hua afatgjatë	13	288,404,832	278,004,881	279,323,092
Detyrime për qera financiare	15	13,976,097	7,080,346	7,522,825
Totali i detyrimeve afatgjatë		302,380,929	285,085,227	286,845,917
Detyrime afatshkurtra				
Hua afatshkurtra	14	195,774,394	182,232,791	66,540,836
Pjesa afatshkurter e qerave financiare	15	12,956,364	4,192,321	2,614,996
Llogari të pagueshme tregtare	16	139,896,175	147,159,753	246,200,086
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	17	446,176,800	159,828,586	157,847,131
Parapagimet e arkëtuara	18	73,972,005	43,848,005	186,684,482
Detyrime tatimore	19	975,022	755,084	677,710
Tatim fitimi		-	-	24,282,626
Llogari të pagueshme të tjera	20	3,798,120	3,424,144	4,274,145
Totali i detyrimeve afatshkurtra		873,548,880	541,440,684	689,122,012
Totali i detyrimeve		1,175,929,809	826,525,911	975,967,929
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,965,612,371	1,832,747,941	1,824,124,961

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 -28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	2,233,501,824	2,257,439,009
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	22	-	145,926,843
Të ardhura të tjera	23	60,360,676	18,044,769
Total të ardhura		2,293,862,500	2,421,410,621
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(1,964,673,649)	(2,039,332,954)
Lende të para dhe materiale për prodhimin e aktiveve	25	-	(51,509,939)
Shpenzime personeli	26	(37,680,313)	(31,798,422)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	27	(66,406,988)	(43,386,399)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	(60,503,371)	(60,083,454)
Total shpenzime		(2,129,264,321)	(2,226,111,168)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	29	(18,178,524)	(14,882,420)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	30	5,906,885	6,637,867
Fitimi/humbja para tatimit		152,326,540	187,054,900
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	31	(24,235,570)	(28,989,902)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(24,235,570)	(28,989,902)
Fitimi/humbja e vitit		128,090,970	158,064,998
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		128,090,970	158,064,998

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.


(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2018	592,834,000	3,751,373	38,548,566	213,023,093	848,157,032
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse per vitin:				158,064,998	158,064,998
Transferim ne rezerva	10,651,153	202,371,940	(213,023,093)	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2018	592,834,000	14,402,526	240,920,506	158,064,998	1,006,222,030
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse per vitin:				128,090,970	128,090,970
Transferim ne rezerva	15,806,500	(15,806,500)	-	-	-
Dividendë të paguar	(202,371,940)	(142,258,498)	(344,630,438)	-	(344,630,438)
Pozicioni më 31 Dhjetor 2019	592,834,000	30,209,026	38,548,566	128,090,970	789,682,562

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori i MEKTRIN MOTORS sh.p.k më 29.12.2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Z. Arian Cyrbja
Hartues i Pasqyrave
Financiare


Z. Edmond Shahini
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	128,090,970	158,064,998
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime amortizimi	57,440,496	43,386,399
Shpenzime zhvlerësimi	8,966,492	
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Vlera neto e aktiveve të nxjerra jashtë perdorimit	231,240	
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(131,961,874)	(23,945,881)
Rënie/(rritje) në inventarë	137,012,682	108,453,079
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	279,678,550	(122,114,129)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	-	8,561,605
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	30,124,000	(142,836,477)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	509,582,556	29,569,594
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(162,724,371)	(198,396,250)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(162,724,371)	(198,396,250)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Rritje/(Rënie) në huatë afatshkurtër	13,541,603	117,269,280
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	10,399,951	(1,760,690)
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	15,659,794	
Dividendë të paguar	(344,630,438)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(305,029,090)	115,508,590
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	41,829,095	(53,318,066)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	35,497,341	88,815,407
Mjetet monetare në fund të periudhës	77,326,436	35,497,341

11

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria MEKTRIN MOTORS sh.p.k është themeluar më 12.01.2005 dhe regjistruar pranë QKR më 08.02.2005 me NIPT K51408501P. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria MEKTRIN MOTORS sh.p.k është një person juridik privat me përfaqësues ligjor dhe ortak të vetëm Z. Edmond Shahini i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 592,834,000 Lekë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është tregtia me shumicë e pakicë e makinave dhe pjesëve të tyre, dhënia me qira e automjeteve të çdo lloji, marrja e përfaqësisë në aktivitetin tregtar të automjeteve, tregtimi, dhënia me qira e mjeteve detare lundruese të çdo lloji, ndryshime konstruktive të mjeteve motorrike tokësore dhe mjeteve ujore të çdo lloji.

Selia e Shoqërisë ndodhet në autostradën Durrës – Tiranë km 6, Xhafzotaj, Durrës.

Numri i punonjësve në 31 dhjetor 2019 ka qënë 61 punonjës. (2018: 56 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

2.2. Aplikimi për herë të parë i SNRF

Këto pasqyra financiare, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, janë përgatitur nga Shoqëria për herë të parë në përputhje me SNRF. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me parimet e pranura përgjithësisht të kontabilitetit lokal (Standardet Kombëtare të Kontabilitetit). Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNRF për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, së bashku me të dhënat krahasuese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018, siç përshkruhet në përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit. Zbatimi i SNRF ka rezultuar në riklasifikimin e pasqyrave financiare si më poshtë për fillimin dhe përfundimin e periudhës krahasuese:

- a) Tatim fitimi i arkëtueshëm është paraqitur më vete në pasqyrën e pozicionit duke riklasifikuar vlerën 2,519,823 Lek nga "Llogari të arkëtueshme të tjera";
- b) Riklasifikimi i diferencave të këmbimit me vlerë 7,794,368 LE nga "Të ardhura të tjera" në "Shpenzime të tjera financiare".

2.3. Baza e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.4. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhme të prekur. Informacioni për çështjet e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përfshirë në shënimin 5.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qirasë.

Shoqëria ka analizuar kontratat e qirasë dhe i ka eliminuar nga klasifikimi si qira financiare pasi janë qira afatshkurtra për një periudhe me pak se 12 muaj.

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për Shoqërinë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në Shoqëri:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plani i ndryshimit ose zgjidhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2019)
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektive për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)

(Vlerat janë në Lek)

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

- Ameidimet në SNK 28 “Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures” (detyrimisht efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2019)
- SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” (detyrimisht efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2021)

Bordi Nderkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat Shoqëria ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto standard dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Kuadri konceptual I rishikuar për Raportimin Financiar – efektiv për periudhat pas 1 janar 2020

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

4.2. Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Shoqëria klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Shoqëria menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësisia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Shoqëria kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paftësisë së pagesës ose falimentimit.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Shoqërisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Aktivitet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për t'ja sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitet. Kosto e aktivitet të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitet në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, koston e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe koston e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

*(Vlerat janë në Lek)***4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***(ii) Njohja dhe matja (vazhdim)*

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Zhvlerësimi llogaritet bazuar në metodën e zhvlerësimit të vlerës së mbetur, gjatë jetës së dobishme të asetit fiks, duke filluar nga dita e parë e muajit pasues me muajin e blerjes. Aktivet nën qira financiare amortizohen bazuar në periudhën më të shkurtër midis qirasë financiare dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi vjetor pasqyrohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Shoqëria llogarit amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale bazuar në jetën e dobishme të tyre sipas gjykimit të manaxhimit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %

Toka nuk amortizohet.

(iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet jo financiare

Për aktivet (përjashtuar emrin e mirë), vlerësimi bëhet në çdo datë raportimi nëse ka indikacione se humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë nuk mund të ekzistojë ose mund të reduktohet. Nëse treguesi i tillë ekziston, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë anulohet vetëm nëse ka pasur ndryshime në supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme të aktivitetit, nga humbja e fundit e njohur e zhvlerësimit. Kthimi është i kufizuar në masën që vlera kontabël neto e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e rikuperueshme dhe nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do të ishte njohur për aktivitetin në vitet e mëparshme.

Një kthim i tillë njihet në pasqyrën e të ardhurave, përveç nëse aktivi kryhet me kosto të rivlerësuar, në të cilin rast kthimi do të trajtohet si një rritje rivlerësimi.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

4.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burime diferencash të përkohshme që vijnë nga tatimi i shtyrë mbi fitimin.

4.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare individuale. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare individuale por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkakimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Shoqëria konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit (vazhdim)

Shoqëria vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Shoqërisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjeti transporti	Mobilje zyre dhe pajisje informatike	Aktive në proces	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2018	194,164,000	401,957,506	36,179,391	39,057,742	41,653,543	47,581,624	760,593,806
Shtesa			7,729,940	9,740,550	33,238,114	147,687,644	198,396,248
Gjendja më 31 dhjetor 2018	194,164,000	401,957,506	43,909,331	48,798,292	74,891,657	195,269,268	958,990,054
Shtesa			1,288,719	154,532,609	6,903,043	(195,269,268)	162,724,371
Transferime		195,269,268		(37,500)	(254,917)		(292,417)
Nxjerrje jashtë përdorimit							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	194,164,000	597,226,774	45,198,050	203,293,401	81,539,783	-	1,121,422,008
Zhvlërësimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2018	-	9,594,668	11,367,488	11,358,524	13,355,796		45,676,476
Amortizimi i vitit		19,625,281	7,541,629	6,917,069	9,302,420		43,386,399
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	29,219,949	18,909,117	18,275,593	22,658,216	-	89,062,875
Amortizimi i vitit		27,586,389	4,877,883	12,974,689	12,001,535		57,440,496
Nxjerrje jashtë përdorimit					(61,177)		(61,177)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	56,806,338	23,787,000	31,250,282	34,598,574	-	146,442,194
<i>Vlera neto kontabël</i>							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	194,164,000	372,737,557	25,000,214	30,522,699	52,233,441	195,269,268	869,927,179
Gjendja më 31 dhjetor 2019	194,164,000	540,420,436	21,411,050	172,043,119	46,941,209	-	974,979,814

7. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra për rishitje/ Pjesë këmbimi automjete	92,913,382	77,500,109
Materiale të para	1,901,480	1,901,480
Automjete për rishitje	451,918,460	601,059,775
Lënde djegese	1,123,128	743,460
Mallra në tranzit (në magazinë doganore)	-	4,693,396
Parapagime për furnizime	2,753,499	1,724,411
	<u>550,609,949</u>	<u>687,622,631</u>

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klient	368,026,456	238,983,018
Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme	(22,210,724)	(13,244,232)
	<u>345,815,732</u>	<u>225,738,786</u>

9. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Garanci të tjera	7,046,096	5,723,118
TVSH për t'u arkëtuar	1,106,360	5,719,063
Të tjera detyrime tatimore	313	-
	<u>8,152,769</u>	<u>11,442,181</u>

10. Tatim fitimi

Tatim fitimi më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim fitimi	8,727,671	2,519,823
	<u>8,727,671</u>	<u>2,519,823</u>

MEKTRIN MOTORS sh.p.k.**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***11. Mjete monetare**

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	72,390,676	35,419,033
Në Lekë	8,471,264	5,451,915
Në monedhë	63,919,412	29,967,118
Mjete monetare në arkë	4,935,760	78,308
Në Lekë	4,935,760	78,308
	<u>77,326,436</u>	<u>35,497,341</u>

12. KapitaliKapitali i shoqërisë është 592,834,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga ortaku i vetëm *Z.Edmond Shahini*.

Rezerva të tjera paraqiten në vlerën 38,548,566 lekë. (2018: 240,920,506 lekë).

Rezerva ligjore paraqitet në vlerën 30,209,026 lekë. (2018: 14,402,526 lekë).

Fitimi i ushtrimit më 31 dhjetor 2019 paraqitet në vlerën 128,090,970 lekë. (2018: 158,064,998 lekë).

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale	592,834,000	592,834,000
	<u>592,834,000</u>	<u>592,834,000</u>

13. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kredi bankare Intesa SanPaolo	157,016,820	278,004,881
Kredi bankare Procredit Bank	131,388,012	-
	<u>288,404,832</u>	<u>278,004,881</u>

Shoqëria ka lidhur kontratë huaja me limit financiar 1,500,000 EUR me Procredit Bank për një periudhë 5 vjeçare me normë efektive interesi 5.44% dhe nominal 3%. Shoqëria ka lënë peng 24 automjete dhe të ardhurat mujore që përfitohen nga kontrata leasing e automjeteve e lidhur me Postën Shqiptare.

Gjithashtu, Shoqëria ka lidhur dy kontrata huaje me Intesa SanPaolo Bank, përkatësisht 1,450,000 EUR për një periudhë 7 vjeçare për qëllim blerje makinash/pjese këmbimi dhe investimi, norma interesi përkatësisht EURIBOR +3% e jo me i vogël se 3.125%, ku Shoqëria ka lënë peng tokë me sipërfaqe rreth 17,000 m2 ku do të kryhet investimi i ri. Kontrata e dytë është lidhur në vlerën 1,700,000 EUR për një periudhë 7 vjeçare për qëllime investimi me një normë interesi EURIBOR +2.5% e jo më të ulët se 2.5%, ku është lënë peng ndërtesa ekzistuese me nr. pasurie 59/50 dhe tre ndërtesat e reja që do të ndërtohen.

14. Detyrime për qira financiare

Detyrimet për qira financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Pjesa afatshkurter e qirasë financiare	12,956,364	4,192,321
Pjesa afatgjatë e qirasë financiare	13,976,097	7,080,346
	<u>26,932,461</u>	<u>11,272,667</u>

15. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Overdraft FI bank	48,541,331	61,297,686
Overdraft Intesa SanPaolo Bank	50,405,787	61,690,508
Pjesa afatshkurter e huasë afatgjatë	96,827,276	59,244,597
	<u>195,774,394</u>	<u>182,232,791</u>

16. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë	139,896,175	142,466,357
Furnitorë për fatura të pambërritura	-	4,693,396
	<u>139,896,175</u>	<u>147,159,753</u>

17. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Dividendë për t'u paguar	338,210,003	21,150,000
Detyrime të tjera ndaj ortakëve	107,966,797	138,678,586
	<u>446,176,800</u>	<u>159,828,586</u>

18. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime të arkëtuara shitje vendase	73,972,005	43,848,005
	<u>73,972,005</u>	<u>43,848,005</u>

19. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore	769,727	638,769
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	205,295	116,315
	<u>975,022</u>	<u>755,084</u>

20. Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga të pagueshme	3,798,120	3,276,111
Të tjera të pagueshme	-	148,033
	<u>3,798,120</u>	<u>3,424,144</u>

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga shitja e pjeseve te kembimit per automjete	209,802,519	169,309,691
Te ardhura nga shitja e automjeteve	1,979,788,992	1,998,537,933
Te ardhura nga shitja e kamioneve	-	63,120,680
Te ardhura nga shërbimet dhe riparimet	43,910,313	26,470,705
	<u>2,233,501,824</u>	<u>2,257,439,009</u>

22. Punë e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar

Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura prodhim AAM Ndërtesa	-	145,926,843
	<u>-</u>	<u>145,926,843</u>

23. Të ardhura të tjera

Të ardhurat të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga komisionet	28,451,161	546,139
Të ardhura nga shitja AAM-ve (paraqitur neto)	122,512	-
Të ardhura të tjera	470,276	-
Të ardhura nga leasing	1,505,773	1,692,885
Te ardhura nga qeraja	29,810,954	15,805,745
	<u>60,360,676</u>	<u>18,044,769</u>

24. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Kosto e pjeseve te kembimit per automjete	158,812,664	131,864,468
Kosto e automjeteve te shitura	1,800,909,989	1,781,774,012
Kosto e kamionave te shitur	-	40,362,298
Te tjera blerje	4,950,996	85,332,176
	<u>1,964,673,649</u>	<u>2,039,332,954</u>

25. Lende të para dhe materiale për prodhimin e aktiveve

Lendët e para dhe materialet për prodhimin e aktiveve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Punime te tjera	-	27,884,317
Kosto e materialeve te para	-	23,625,622
	<u>-</u>	<u>51,509,939</u>

26. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime paga	32,697,481	27,306,322
Shpenzime për sigurime shoqërore	4,982,832	4,492,100
	<u>37,680,313</u>	<u>31,798,422</u>

Per vitin 2019 shoqëria ka mesatarisht 60 punonjes. Struktura e personelit perbehet si me poshte:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Administratë	25
Shitje	8
Pas shitje	27
	<u>60</u>

27. Shpenzime të zhlerësimit dhe amortizimit

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	57,440,496	43,386,399
Shpenzime zhvleresimi	8,966,492	-
	<u>66,406,988</u>	<u>43,386,399</u>

28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime energji, avuj, uje	4,294,304	3,476,114
Shpenzim për trajnime	2,431,714	4,384,078
Shpenzime transporti personeli e të tjera	1,041,027	778,875
Mirëmbajtje dhe riparime	3,464,262	3,648,528
Sigurime	7,850,267	3,042,602
Udhëtime e dieta	5,103,625	5,812,790
Roje private	2,666,667	-
Qera	1,514,630	570,609
Shpenzime ligjore e konsulenca	369,433	-
Shpenzime agjensie	524,196	567,983
Shpenzime marketingu	5,823,230	4,306,694
Shpenzime telefon dhe internet	1,086,870	1,077,418
Tatime dhe taksa vendore	3,383,175	4,757,720
Tarife skanimit në doganë	324,597	421,909
Gjoha e dëmshpërblime	382,300	3,176,083
Dhurata e donacione	738,223	97,750
Sherbime bankare	2,753,597	2,507,777
Të tjera shpenzime për personelin	1,962,031	12,690,970
Të tjera shpenzime	14,789,223	8,765,554
	60,503,371	60,083,454

Në sherbime konsulente nga të tretë përfshihen shërbime auditimi dhe dhënie të tjera sigurie nga audituesi i pasqyrave financiare në shumën 1,308,000 lekë

29. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime per interesa	14,983,969	12,213,294
Qera financiare	3,194,706	2,860,377
Te ardhura nga interesat	(151)	(191,251)
	18,178,524	14,882,420

30. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Garanci Bankare Societe Generale	1,065,826	1,156,501
Rezultati neto nga këmbimet valutore	(6,972,711)	(7,794,368)
	(5,906,885)	(6,637,867)

31. Shpenzim i tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	152,326,540	187,054,900
Total shpenzime të panjohura	9,243,928	6,211,115
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	382,300	3,176,083
Humbje nga mosarketimi i të trëteve	675,216	
Shpenzime të tjera	8,186,412	3,035,032
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	161,570,468	193,266,015
 <i>Tatim fitimi @15%</i>	 24,235,570	 28,989,902
	128,090,970	158,064,998

32. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Të pagueshme ndaj ortakut		446,176,800		159,828,586
	-	446,176,800	-	159,828,586

Shpërblimi total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpërblimi i stafit menaxherial	3,000,000	3,000,000
	3,000,000	3,000,000

33. Manaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë.

Politikat e manaximit të riskut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	267,429,085	12,449,865	96,300,275		376,179,225
Mjete monetare në arkë dhe bankë	77,326,436				77,326,436
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2019	344,755,521	12,449,865	96,300,275	-	453,505,661

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	210,646,637	39,778,562			250,425,199
Mjete monetare në arkë dhe bankë	35,497,341				35,497,341
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2018	246,143,978	39,778,562	-	-	285,922,540

33. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të kompanisë.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018:

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	376,179,225				376,179,225
Mjete monetare në arkë dhe bankë	77,326,436				77,326,436
Totali	453,505,661	-	-	-	453,505,661
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(590,846,117)				(590,846,117)
Hua	(154,968,491)	(53,762,267)	(302,380,929)		(511,111,687)
Totali	(745,814,608)	(53,762,267)	(302,380,929)	-	(1,101,957,804)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(292,308,947)	(53,762,267)	(302,380,929)	-	(648,452,143)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	250,425,199				250,425,199
Mjete monetare në arkë dhe bankë	35,497,341				35,497,341
Totali	285,922,540	-	-	-	285,922,540
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(311,167,567)				(311,167,567)
Hua	(160,414,464)	(26,010,648)	(285,085,227)		(471,510,339)
Totali	(471,582,031)	(26,010,648)	(285,085,227)	-	(782,677,906)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	(185,659,491)	(26,010,648)	(285,085,227)	-	(496,755,366)

33. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i valutës

Ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				
	EUR	ALL	USD	GBP	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	303,847,494	72,331,732			376,179,226
Mjete monetare në arkë dhe bankë	63,919,412	13,407,024			77,326,436
Totali	367,766,906	85,738,756	-	-	453,505,661
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera Hua	(44,166,542)	(543,745,509)	(2,934,066)		(590,846,117)
	(511,111,687)				(511,111,687)
Totali	(555,278,229)	(543,745,509)	(2,934,066)	-	(1,101,957,804)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	(187,511,323)	(458,006,753)	(2,934,066)	-	(648,452,143)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				
	EUR	ALL	USD	GBP	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	199,748,708	50,676,491			250,425,199
Mjete monetare në arkë dhe bankë	29,967,118	5,530,223			35,497,341
Totali	229,715,826	56,206,714	-	-	285,922,540
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera Hua	(25,056,739)	(282,940,448)	(3,170,381)		(311,167,567)
	(471,510,339)				(471,510,339)
Totali	(496,567,078)	(282,940,448)	(3,170,381)	-	(782,677,906)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	(266,851,252)	(226,733,733)	(3,170,381)	-	(496,755,366)

(d) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohen se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivitet dhe detyrimet e shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Në datën e raportit, instrumentat financiarë mbartës të normave të interesit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor	
	2019	2018
Instrumenta me interes fikse		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	26,932,461	11,272,667
Instrumenta me interes variable		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare		

34. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

35. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare.

Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Shoqëria gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt.

Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë të pasqyrat financiare individuale.

Z. Edmond Shahini
Administrator

